

PRISHTINË, JANAR 2020

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

Menaxhimi i financave



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

Menaxhimi i financave

Prishtinë, janar 2020

Publikues:

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Simon Shiroka, H-11, Nr. 8

Pristina, 10000, Kosova

Hulumtues dhe autorë:

Liridona Ademaj

Skord Retkoceri



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.
Falna durimin të thellojmë një punë përpara
se të shkruajë mbi të! Frymëzona me një
ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje.....	7
Konteksti	8
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”	10
Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”	12
Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”	14
Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”	16
Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”	18
Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”	20
Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.....	22

HYRJE

Fondet publike përbëjnë burimin kryesor të financimit për universitetet publike, prandaj transparencja dhe llogaridhënia e këtyre institucioneve është e domosdoshme.

Të dhënat në këtë raport, janë marrë nga raportet e buxhetit të universiteteve publike, nga Zyra Kombëtare e Auditimit, si dhe nga Agjencia e Kosovës për Statistika.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ka refuzuar që t'i ndajë me ORCA-n, Raportin e auditimit të brendshëm për gjashtë universitetet publike, si dhe Raportin financiar të shpenzimeve të universiteteve publike.

Pavarësisht Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Memorandumit për Bashkëpunim në mes të ORCA-s dhe MASHT-it, kërkesa për qasje në këto dokumente është refuzuar.

KONTEKSTI

Në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë për vitin 2017-2021¹(PSAK), shpenzimet për kokë banori në arsimin e lartë janë 703 euro. Në vitin 2017, për arsimin e lartë ishin paraparë të shpenzohen 2 milionë e 647 mijë euro, në vitin 2018, 3 milionë e 478 mijë euro, në vitin 2019, 3 milionë e 648 mijë euro, në vitin 2020, 5 milionë e 99 mijë euro, ndërkaq në vitin 2021, janë planifikuar të shpenzohen 7 milionë e 357 mijë euro, pra gjithsej 22 milionë e 232 mijë euro.

Sa i përket kategorive ekonomike, vetëm në paga dhe mëditje janë planifikuar të shpenzohen 9 milionë e 478 mijë euro, ndërsa për subvencione dhe transfere, janë paraparë të shpenzohen 7 milionë e 600 mijë euro. Për arsimin e lartë, MASHT-i ndanë 7 milionë e 636 mijë euro, agjencitë tjera 10 milionë e 488 mijë euro, ndërkaq donatorët 4 milionë e 108 mijë euro, pra gjithsej 22 milionë e 232 mijë euro.

Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN), ka publikuar vlerësimin afatmesëm të zbatimit të PSAK-së. Pjesa dërrmuese e shpenzimeve në arsimin e lartë, vazhdojnë t'i dedikohen Universitetit të Prishtinës (65.5%). Institucionet tjera publike të arsimit të lartë, përbëjnë 34.5% të shpenzimeve në arsimin e lartë. Ndërkaq, buxheti i përgjithshëm i ndarë për universitetet publike për vitin 2019, është 53 milion euro. Sa i përket fondit për kërkime shkencore, KEEN ka gjetur se mungojnë informata publike për shpenzimet e realizuara, si dhe nuk ka dëshmi llogaridhënëse për shpenzimet buxhetore, duke përfshirë hulumtuesit shkencor, kontributet e pritshme shkencore dhe praktike të projekteve hulumtuese të financuara. Nga Fondi për Shkencë, MASHT ka ndarë nga 396 mijë euro në vitin 2017 dhe 2018, ndërkohë që në vitin 2019, janë ndarë 1 milion e 252 mijë euro.²

Në raportin “Borgjezia” e Akademisë (2019), ORCA ka hulumtuar deklaratat e pasurisë të vitit 2018 të stafit akademik menaxherial të të gjitha universiteteve publike në Kosovë, të publikuara në uebfaqen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Në hulumtim janë të përfshirë Këshilli Drejtues, Rektori, prorektorët, dekanët, dhe prodekanët e shtatë universiteteve publike. Në total, 170 profesorë me pozita menaxheriale në universitetet publike të Kosovës

¹ https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

² KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021

paguhen 313,354 euro në muaj, nga të cilat mbi 124 mijë euro janë shtesa (40% e të ardhurave mujore). Rektorët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 2517 euro në muaj, nga të cilat mesatarisht 1,171 euro janë shtesa; prorektorët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 2,301 euro në muaj; dekanët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 2202 euro në muaj; Prodekanët e universiteteve publike paguhen mesatarisht 1,927 euro në muaj. Ahmet Shala, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Universitet të Prishtinës është më i paguari me 3,367 euro në muaj. Krahasimisht, rroga më e lartë në Kosovë, ajo e presidentit, është 2,390 euro në muaj, sipas ligjit të ri të pagave për sektorin publik.³

Mesatarja e shpenzimeve për kokë studenti në universitete publike në vitin 2019, është vetëm 781 euro.⁴ Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore TM3 2019 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vetëm 15% e personave të moshës 15-24 janë të punësuar. Tek vajzat dhe gratë kjo shifër është edhe më e ulët, vetëm 8% e tyre në këtë grup-moshë janë të punësuar, për dallim nga djemtë dhe burrat 21%. Ndërsa sa i përket grup-moshës 25-34 përqindja e të punësuarve është 38.4%. Tek burrat kjo përqindje është 54.7% ndërsa për gra vetëm 19.4%.⁵

Numri i përgjithshëm i personelit akademik të rregullt në universitete publike, është 1 mijë e 296 (453 gra dhe 843 burra), ndërsa i të angazhuarve, është 900 (329 gra dhe 571 burra).

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në nivelin Bachelor nga të gjitha universitetet publike, është 58 mijë e 59 studentë. Ndërkaq numri i studentëve të diplomuar (2018/2019), është 7 mijë e 684.

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në nivelin Master është 9 mijë e 836. Ndërkohë që numri i studentëve të diplomuar në këtë nivel (2018/2019), është 2 mijë e 334.

³ <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/Borgjezia-e-Akademis%C3%AB-1.pdf>

⁴ KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021

⁵ <https://ask.rks-gov.net/media/5214/afp-tm3-2019-shqip.pdf>



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Prishtinës, janë ndarë gjithsej 34 milionë e 785 mijë e 502 euro vetëm për vitin 2019.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet, shkon për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 21 milionë e 263 mijë e 857 euro apo 61%, të parapara për 2 mijë e 81 të punësuar.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Prishtinës, ka gjithsej 930 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 339 apo 36% gra, si dhe 452 të angazhuar, prej tyre 195 apo 43% gra.

Në vitin 2018, ORCA ka analizuar pasqyrat e angazhimit të stafit akademik dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm për secilin fakultet për vitin akademik 2017/2018⁶.

Gjatë vitit akademik 2017/2018, UP kishte shpenzuar 2.333.060 Euro për mbinorma të stafit ekzistues akademik. Ndërsa për të njëjtin vit akademik, për bashkëpunëtorë të jashtëm kishte shpenzuar 1.036.265. Në total del se UP gjatë vitit akademik ka shpenzuar 3.368.325 Euro për mbinorma dhe bashkëpunëtorë të jashtëm.



Në nivelin Bachelor, UP ka gjithsej 33 mijë e 18 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 6 mijë e 682 studentë, ndërsa kandidatë të pranuar në studimet e doktoratës ka gjithsej 66.

Ndërkaq me 3.3 milion Euro, UP do të mund të punësonte 247 profesorë asistent gjë që do të shënonte rritje prej 50% të stafit ekzistues akademik, i cili përbëhet prej më shumë se 550 veta me tituj profesorialë (Profesor Asistent, Profesor i Asocuar, Profesor i Rregullt).

Në anën tjetër, shpenzimet vjetore për kokë studenti në Universitetin e Prishtinës janë vetëm 876 euro.⁷

⁶ http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2018/10/Analiza-e-mbinormave_Shqip_Web.pdf

⁷ KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021



Në nivelin Bachelor, UP ka gjithsej 33 mijë e 18 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 6 mijë e 682 studentë, ndërsa kandidatë të pranuar në studimet e doktoratës ka gjithsej 66.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 19 mijë e 160 vajza dhe 13 mijë e 858 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 3 mijë e 400 vajza dhe 1 mijë e 904 djem, pra 5 mijë e 304 të diplomuar.

Në nivelin Master, janë gjithsej 4 mijë e 5 vajza dhe 2 mijë e 677 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 1 mijë e 145 vajza dhe 824 djem, pra 1 mijë e 969 të diplomuar.

Në doktoratë, janë gjithsej 35 vajza dhe 31 djem.

Raporti profesor - student në Universitetin e Prishtinës është 1:46.⁸

Linja buxhetore për Universitetin e Prishtinës, 2019

Shpenzimet Përqindja

Pagat dhe mëditjet **21,263,857** **61.13%**

Mallrat dhe shërbimet **3,402,645** **9.78%**

Shpenzimet komunale **7,500,000** **4.15%**

Subvencionet dhe transferet **1,444,000** **4.15%**

Shpenzimet kapitale **7,500,000** **21.56%**

Total Shpenzimet 2019 **34,785,502** **100%**



UNIVERSITETI I PRIZRENIT “UKSHIN HOTI”

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Prizrenit, janë ndarë gjithsej 2 milionë e 826 mijë e 772 euro vetëm për vitin 2019.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet, shkon për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 1 milionë e 853 mijë e 772 euro apo 65%, të parapara për 147 të punësuar.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Prizrenit, ka gjithsej 65 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 18 apo 28% gra, si dhe 182 të angazhuar, prej tyre 61 apo 33% gra.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka publikuar Raportin e Auditimit për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2018. Ky auditim është bazuar në analizimin e pasqyrave financiare vjetore, menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe zbatimin e rekomandimeve.

Në Raportin e Auditimit për MASHT-in për vitin 2018⁹, janë gjetur këto parregullsi në Universitetin e Prizrenit: Tek çështja A3 “Pagesat e bëra për profesorët në Universi-

tetin e Prizrenit për orët mbi normë”, Zyra e Auditorit ka gjetur se dy profesorëve u është bërë kompensimi për orët mbinormë, edhe pse nuk kishte dëshmi se orët janë mbajtur. Tutje është sqaruar se vlera e paguar pa dëshmi për këto dy raste, është 500 euro.

Menaxhmenti i këtij universiteti, i ka thënë Zyrës së Auditorit se ky kompensim është bërë duke u bazuar në mbajtjen e provimeve, edhe pse mbajtja e provimeve është e paraparë të kryhet në kuadër të orëve të rregullta.

Kjo zyrë i ka rekomanduar ministrit të Arsimit dhe Rektorit të universitetit, që të sigurohen se pagesat do të bëhen vetëm për orët e mbajtura jashtë norme, dhe pagesat pa dëshmi për mbajtjen e orëve mësimore të kthehen në buxhetin e ministrisë.

ZKA ka treguar se rekomandimi i vitit 2015 që ndërlidhet me auditorin e brendshëm në Universitetin e Prizrenit ende nuk është adresuar. Auditori i brendshëm në UPZ, vazhdon të paguhet pa kryer asnjë raport të auditimit për shkak se Ministria dhe UPZ nuk kanë arritur një dakordim për mënyrën e angazhimit.

⁹ <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/06/Raporti-MASHT-E.pdf>



Linja buxhetore për Universitetin e Prizrenit, 2019

Universiteti i Prizrenit, në nivelin Bachelor ka gjithsej 5 mijë e 388 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 259 studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 3 mijë e 703 vajza dhe 1 mijë e 685 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 482 vajza dhe 240 djem, pra 722 të diplomuar.

Në nivelin Master, janë gjithsej 126 vajza dhe 133 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 65 vajza dhe 39 djem, pra 104 të diplomuar.

Raporti profesor student në Universitetin e Prizrenit është 1:73. Shpenzimet vjetore për kokë studentit, në Universitetin e Prizrenit janë vetëm 501 euro.¹⁰

Shpenzimet Përqindja

Pagat dhe mëditjet	1,853,772.00	65.58%
Mallrat dhe shërbimet	600,000.00	21.23%
Shpenzimet komunale	73,000.00	2.58%
Subvencionet dhe transferet	100,000.00	3.54%
Shpenzimet kapitale	200,000.00	7.08%
Total Shpenzimet 2019	2,826,772.00	100%

¹⁰ KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021



UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Gjakovës, janë ndarë gjithsej 2 milionë e 460 mijë e 46 euro vetëm për vitin 2019.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet, shkon për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 1 milionë e 243 mijë e 707 euro apo 50%, të parapara për 111 të punësuar.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Gjakovës, ka gjithsej 43 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 19 apo 44% gra, si dhe 51 të angazhuar, prej tyre 15 apo 29% gra.

Universiteti i Gjakovës nuk ka detaje rreth shpenzimeve buxhetore. Në raportin e publikuar në faqe zyrtare, janë vendosura vetëm kategoritë dhe shuma totale për secilën prej tyre.¹¹

Universiteti i Gjakovës, në nivelin Bachelor ka gjithsej 2 mijë e 419 studentë, në nivelin Master nuk ka studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 1 mijë e 854 vajza dhe 565 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 335 vajza dhe 56 djem, pra 391 të diplomuar.

Në nivelin Master, nuk ka studentë të regjistruar.

Raporti profesor - student është 48:1, ndërsa shpenzimet për student në vitin 2019 janë 1,061 euro për kokë studentit.¹²

¹¹ <https://uni-gjk.org/upload/dokumentet/91722-Analiza%20e%20shpenzimeve%20p%C3%ABr%20vitin%202018.pdf>

¹² KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021



Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 1 mijë e 854 vajza dhe 565 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 335 vajza dhe 56 djem, pra 391 të diplomuar.



LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E GJAKOVËS, 2019

Shpenzimet Përqindja

Pagat dhe
mëditjet 1,243,707.00 **50.56%**

Mallrat dhe
shërbimet 316,339.00 **12.86%**

Shpenzimet
komunale 50,000.00 **2.03%**

Subvencionet
dhe transferet 100,000.00 **4.06%**

Shpenzimet
kapitale 750,000.00 **30.49%**

**Total
Shpenzimet
2019** **2,460,046.00** **100%**



UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Mitrovicës, janë ndarë gjithsej 4 milionë e 788 mijë e 969 euro vetëm për vitin 2019.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet, shkon për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 2 milionë e 757 mijë e 430 euro apo 57%, të parapara për 147 të punësuar.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Mitrovicës, ka gjithsej 103 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 30 apo 29% gra, si dhe 45 të angazhuar, prej tyre 16 apo 36% gra.

Në buxhetin e publikuar nga UMIB¹³, për vitin 2019 thuhet se nga buxheti i shtetit kanë marrë gjithsej 2 milionë e 642 mijë e 769 euro, ndërkohë që nga të hyrat vetanake, kanë arritur të sigurojnë 114 mijë e 661 euro.

Në pasqyrën e pagës mujore, rektori i këtij universiteti ka marrë 2 mijë e 731 euro për muaj, ndërsa tre prorektorët, nga shuma totale prej 6 mijë e 595 eurove, kanë marrë nga 2 mijë e 198 euro.

Për profesorë të rregullt në këtë universitet, janë ndarë gjithsej 32 mijë e 375 euro nga buxheti i shtetit, pra këta profesorë kanë marrë nga 2 mijë e 23 euro.

Ndërsa dhjetë profesorë të Asocuar, i kanë kushtuar buxhetit të vendit 18 mijë e 575 euro, konkretisht nga 1 mijë e 857 euro.

Për 30 profesorë Asistent, janë ndarë 41 mijë e 133 mijë euro, nga 1 mijë e 371 euro për profesor.

48 asistentë, i kanë kushtuar buxhetit të vendit 41 mijë e 132 euro, nga 857 euro.

Sa i përket investimeve kapitale, UMIB ka pasur në dispozicion 1 milion e 50 mijë euro,

¹³ <https://www.umib.net/ep-content/uploads/2020/01/buxheti-2019.pdf>



LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E MITROVICËS, 2019

Shpenzimet Përqindja

Universiteti i Mitrovicës, në nivelin Bachelor ka gjithsej 2 mijë e 676 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 212 studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 1 mijë e 606 vajza dhe 1 mijë e 70 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 155 vajza dhe 104 djem, pra 259 të diplomuar.

Në nivelin Master, janë gjithsej 98 vajza dhe 114 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 23 vajza dhe 24 djem, pra 47 të diplomuar.

Raporti profesor - student është 30:1, ndërsa shpenzimet për studentë në vitin 2019 janë 1,658 euro për kokë studentit.¹⁴

Pagat dhe
mëditjet

2,757,430.00 **57.58%**

Mallrat dhe
shërbimet

866,339.00 **18.09%**

Shpenzimet
komunale

215,200.00 **4.49%**

Subvencionet
dhe transferet

100,000.00 **2.09%**

Shpenzimet
kapitale

850,000.00 **17.75%**

**Total
Shpenzimet
2019**

4,788,969.00 **100%**

¹⁴ KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021



UNIVERSITETI I PEJËS “HAXHI ZEKA”

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Pejës, janë ndarë gjithsej 3 milionë e 628 mijë e 197 euro vetëm për vitin 2019.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet, shkon për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 2 milionë e 95 mijë e 782 euro apo 57%, të parapara për 162 **të punësuar**.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Pejës, ka gjithsej 72 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 30 apo 42% gra, si dhe 91 të angazhuar, prej tyre 20 apo 22% gra.

Në raportin e buxhetit të UHZ-së për periudhën janar-tetor 2019, të hyrat nga pagesat e studentëve kanë arritur vlerën prej 111 mijë e 400 eurove.

Nga Fakulteti i Biznesit kanë grumbulluar 84 mijë e 192 euro të hyra, nga Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm dhe Hotelieri, 8 mijë e 413 euro, nga Fakulteti Juridik, 37 mijë e 264 euro, nga Fakulteti i Arteve, 2 mijë e 331 euro, si dhe nga Fakulteti i Agrobiznesit, 6 mijë e 445 euro. Ndërkohë që shpenzimet për paga dhe mëditje, kanë arritur vlerën prej 1 milionë e 564 mijë e 928 euro, ku 1 milionë e 304 mijë e 409 euro janë shpenzuar vetëm për paga neto (sipas raportit nëntë mujor të UHZ-së, për 229 të punësuar), 73 mijë e 408 euro për kontribute pensionale nga punëdhënësi, 112 mijë e 244 euro tatim nga të hyrat personale, si dhe 1 mijë e 457

për Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK).

Tek subvencionet dhe transferet, UHZ ka deklaruar në raportin nëntë mujor se shpenzimet kanë arritur vlerën prej 1 milionë e 676 mijë eurove, mirëpo kjo shumë nuk ka të dhëna të detajuara për mënyrën se si është shpenzuar konkretisht.

Ndërkaq, shpenzimet kapitale, kapin vlerën prej 224 mijë e 869 eurove, të cilat janë shpenzuar për projektin “Ndërtim dhe renovim i infrastrukturës së UHZ-së”.

Tek çështja A5 e raportit të Auditorit të Përgjithshëm, “*Angazhime tjera në kundërshtim me rregulloren për të ardhurat personale*”, Zyra e Auditorit ka gjetur se gjashtë profesorë në Universitet të Pejës, kishin kryer shkelje të Rregullores për të ardhura personale për stafin akademik në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë. Këta profesorë, të cilët kanë marrëdhënie të rregullt të punës dhe kontratë me orë mbinormë me Universitetin e Pejës, ishin angazhuar me kontratë pune me honorarë edhe në universitete tjera.

Dy prej tyre ishin të angazhuar në Universitetin e Prizrenit, një në Universitetin e Ferizajit dhe tre profesorë në Universitetin e Prishtinës, gjë që përbën shkelje të Rregullores për të ardhura personale në Universitet të Pejës.

UHZ u kishte kërkuar këtyre profesorëve që të deklarojnë pagën sekondare dhe nëse nuk kanë të tillë, ta nënshkruajnë deklaratën se nuk kanë angazhime shtesë.

Gjashtë profesorët e UHZ-së kishin nënshkruar këtë deklaratë edhe pse në të njëjtën kohë kanë qenë të angazhuar dhe janë paguar edhe nga universitetet tjera me honorar.

Zyra e Auditorit ka rekomanduar që Ministri bashkë me Rektorët e universiteteve, të sigurojnë monitorim ndaj personelit akademik në mënyrë që angazhimet e tyre të jenë në harmoni me rregulloren dhe për të gjitha rastet si ky, të rishikohet mundësia e kthimit të mjeteve dhe statusi i ardhshëm i angazhimit të këtij stafi.

Universiteti i Pejës, në nivelin Bachelor ka gjithsej 10 mijë e 479 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 2 mijë e 498 student, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 4 mijë e 248 vajza dhe 6 mijë e 231 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 335 vajza dhe 203 djem, pra 538 të diplomuar.

Në nivelin Master, janë gjithsej 1 mijë e 419 vajza dhe 1 mijë e 79 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 121 vajza dhe 77 djem, pra 198 të diplomuar.


Raporti profesor - student është 191:1, ndërsa shpenzimet për studentë në vitin 2019 janë 279 euro për kokë studentit.¹⁵

¹⁵ KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021



LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E PEJËS, 2019

Shpenzimet Përqindja





UNIVERSITETI I GJILANIT “KADRI ZEKA”

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Gjilanit, janë ndarë gjithsej 2 milionë e 363 mijë e 982 euro vetëm për vitin 2019.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet, shkon për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 1 milionë e 297 mijë e 643 euro apo 55%, të parapara për **115 të punësuar**.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Universiteti i Gjilanit, ka gjithsej 38 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 8 apo 21% gra, si dhe 56 të angazhuar, prej tyre 18 apo 32% gra.

Tek çështja A4, “*Kompensimi i anëtarëve të Senatit në Universitetin e Gjilanit pa mbajtur mbledhje*”, Zyra e Auditorit ka gjetur se 19 anëtarë të Senatit në Universitetin e Gjilanit, ishin kompensuar për katër mbledhje (janar, shkurt, mars dhe qershor 2018), të cilat nuk ishin mbajtur nga Senati. Tutje është sqaruar se vlera e kompensimeve është 5 mijë e 320 euro ($19 \cdot 4 \cdot 70 \text{€} = 5.320 \text{€}$).

Rekomandimi i Auditorit është që Ministri së bashku me Rektoren, të sigurohen se të gjitha pagesat e paarsyetuara për kompensime ndaj anëtarëve të senatit të kthehen në buxhetin e Kosovës.

Universiteti i Gjilanit, në nivelin Bachelor ka gjithsej 2 mijë e 831 studentë, në nivelin Master ka gjithsej 157 studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 1 mijë e 896 vajza dhe 935 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 267 vajza dhe 88 djem, pra 355 të diplomuar.

Në nivelin Master, janë gjithsej 70 vajza dhe 87 djem. Nuk ka të dhëna për studentët të diplomuar në këtë nivel.

Raporti profesor - student është 74:1, ndërsa shpenzimet për studentë në vitin 2019 janë 791 euro për kokë studentit.¹⁶

¹⁶ KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021



LINJA BUXHETORE NË UNIVERSITETIN E GJILANI, 2019



Rekomandimi i Auditorit është që Ministri së bashku me Rektoren, të sigurohen se të gjitha pagesat e paarsyetuara për kompensime ndaj anëtarëve të senatit të kthehen në buxhetin e Kosovës.

Shpenzimet Përqindja

Pagat dhe
mëditjet

1,297,643.00 **54.89%**

Mallrat dhe
shërbimet

316,339.00 **13.38%**

Shpenzimet
komunale

50.000.00 **2.12%**

Subvencionet
dhe transferet

100,000.00 **4.23%**

Shpenzimet
kapitale

600,000.00 **25.38%**

**Total
Shpenzimet
2019**

2,363,982.00 100%



UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, janë ndarë gjithsej 2 milionë e 247 mijë e 227 euro vetëm për vitin 2019.

Shumica e buxhetit të ndarë për këtë universitet, shkon për paga dhe mëditje të stafit akademik, me 777 mijë e 857 euro apo 34%, të parapara për 60 të punësuar.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, USHAF, ka gjithsej 45 punonjës akademik të rregullt, prej tyre 9 apo 20% gra, si dhe 23 të angazhuar, prej tyre 4 apo 17% gra.

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në nivelin Bachelor ka gjithsej 1 mijë e 328 studentë, në nivelin Master ka 58 studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Në nivelin Bachelor, janë gjithsej 709 vajza dhe 619 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 75 vajza dhe 40 djem, pra 115 të diplomuar.

Në nivelin Master, janë gjithsej 11 vajza dhe 17 djem. Ndërkaq sa i përket numrit të studentëve të diplomuar, janë gjithsej 12 vajza dhe 4 djem, pra 16 të diplomuar.

Raporti profesor - student është 41:1, ndërsa shpenzimet për studentë në vitin 2019 janë 1,657 euro për kokë studentit.¹⁷

¹⁷ KEEN, 2019. VLERËSIM AFATMESËM: Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021



LINJA BUXHETORE PËR UNIVERSITETIN E FERIZAJT, 2019



Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në nivelin Bachelor ka gjithsej 1 mijë e 328 studentë, në nivelin Master ka 58 studentë, ndërsa nivelin e doktoratës nuk e ka.

Shpenzimet Përqindja

Pagat dhe mëditjet **777,857.00** **34.61%**

Mallrat dhe shërbimet **228,370.00** **10.16%**

Shpenzimet komunale **21,000.00** **0.93%**

Subvencionet dhe transferet **70,000.00** **3.11%**

Shpenzimet kapitale **1,150,000.00** **51.17%**

Total Shpenzimet 2019 **2,247,227.00** **100%**

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencioni Austriak për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencionit Austriak për Zhvillim.

WITH FUNDING FROM
 AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministërstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologji
Ministry of Education, Science and Technology

